

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Menaxherial
(zgjidhjet)

P2

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT

Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE

All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË

Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Your name should appear nowhere in this test.

Data 10.07.2021

CONTENT / PËRMBAJTJA

SESSION	MAXIMUM ASSIGNED	<u>-ATTENTION! THIS PART IS FOR SCAAK USE ONLY-</u> MARKS AWARDED
1. Problem 1	20	
2. Problem 2	20	
3. Problem 3	20	
4. Problem 4	20	
5. Problem 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Fitimi i pikësnyuar i kompanisë Cutlass për vitin e ardhshëm është si vijon:

	<i>Totali</i>	<i>Për njësi</i>
Shitjet	\$200,000	\$20
Zbresim: Shpenzimet variabël	<u>120,000</u>	<u>12</u>
Marzha e kontributit	\$ 80,000	<u>\$ 8</u>
Zbresim: Shpenzimet fikse	<u>64,000</u>	
Të hyrat operative	<u>\$ 16,000</u>	

Kërkohe:

1. Llogarisni pikën rentabël në njësi.
2. Sa njësi duhet shitur për të nxjerrë një fitim prej 30 000 USD?
3. Llogarisni normën e marzhës së kontributit. Duke përdorur atë normë, llogarisni fitimin shtesë që Cutlass do të nxjerrë, nëse shitjet ishin 25 000 USD më shumë se sa janë parashikuar.
4. Supozoni se Cutlass do të dëshironte të nxirrte të hyra operative, të barabarta me 20 përqind të të ardhurave nga shitjet. Sa njësi duhen shitur që të realizohet ky qëllim? Përgatisni një raport të ardhurash për të provuar përgjigjen tuaj.
5. Për nivelin e parashikuar të shitjeve, llogarisni marzhën e sigurisë.

(Totali = 5 x 4 pikë = 20 pikë)

Zgjidhja 1:

1. Pika rentabël është si vijon:

$$\begin{aligned}\text{Njësité} &= \text{Kostot fikse} / (\text{Çmimi} - \text{Kostoja variabël e njësisë}) \\ &= 64\,000 \text{ USD} / (20 \text{ USD} - 12 \text{ USD}) \\ &= 64\,000 \text{ USD} / 8 \text{ USD} \\ &= 8\,000\end{aligned}$$

2. Numri i njësive që duhet shitur për të nxjerrë një fitim prej 30 000 USD është si vijon:

$$\begin{aligned}\text{Njësité} &= (64\,000 \text{ USD} + 30\,000 \text{ USD}) / 8 \text{ USD} \\ &= 94\,000 \text{ USD} / 8 \text{ USD} \\ &= 11\,750\end{aligned}$$

3. Norma e marzhës së kontributit është $8 \text{ USD} / 20 \text{ USD} = 0.40$. Me shitje shtesë prej 25 000 USD, fitimi shtesë do të jetë $0.40 \times 25\,000 \text{ USD} = 10\,000 \text{ USD}$.

4. Për të gjetur numrin e njësive të shitura për një fitim të barabartë me 20 përqind të shitjeve, le të synojmë të hyrat, të barabarta me $(0.20)(\text{Çmimi} \times \text{Njësité})$ dhe ta zgjidhim për njësité.

$$\begin{aligned}\text{Të hyrat operative} &= (\text{Çmimi} \times \text{Njësité}) - (\text{Kostoja variabël e njësisë} \times \text{Njësité}) - \text{Kostot fikse} \\ (0.2)(\$20)\text{Njësité} &= (\$20 \times \text{Njësité}) - (\$12 \times \text{Njësité}) - \$64\,000 \\ \$4 \times \text{Njësité} &= \$64\,000 \\ \text{Njësité} &= 16\,000\end{aligned}$$

Pasqyra e të hyrave është si vijon:

Shitjet (16,000 x \$20)	\$320,000
Zbresim: Shpenzimet variabël (16,000 x \$12)	<u>192,000</u>
Marzha e kontributit	\$128,000
Zbresim: Shpenzimet fikse	<u>64,000</u>
Të hyrat operative	<u>\$ 64,000</u>

Të hyrat operative / Shitjet = $\$64\,000 / \$320\,000 = 0.20$ ose 20 %.

5. Marzha e sigurisë është $10\,000 - 8\,000 = 2\,000$ njësi ose \$40 000 të ardhura prej shitjeve.

Problemi 2

(Pjesa a) ABC përvetëson shpenzimet e përgjithshme të prodhimit në bazë të orëve direkte të punës.

Më 31 dhjetor llogaria e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit tregonte një saldo kreditore prej €20,000. Kompania ka vlerësuar se gjatë vitit duhej të shfrytëzoheshin 200,000 orë të punës direkte. Numri aktual i orëve të punës direkte ishin 220,000.

Në kartën e punës puna e përfunduar tregonte €330,000 të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit të cilat ishin transferuar në llogarinë e produkteve të gatshme. Nuk kishte punë në process në fillim të vitit dhe puna ishte pjesërisht e përfunduar në fund të vitit, me €110,000 shpenzime të përgjithshme të përvetësuar.

Kërkohej

- a. Çfarë shume të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit kompania do të duhej të vlerësonte në fillim të vitit? (5 pikë)
- b. Cila është shuma aktuale e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit të ndodhura gjatë vitit? (5 pikë)

(Pjesa b) ABC prodhon miell nga kokrrizat e proteinave. Ajo përdor sistemin e procesit të koston. Në muajin Janar kompania kishte startuar me 11,350 njësi dhe i kishte kompletuar dhe transferuar jashtë 8,000 njësi. Procesi i inspektimit tregon në pikën e 60% dhe procesi rezulton me 13.5% produkte të prishura nga produktet e mira si prishje normale. Nuk kishte stoqe fillestare në Janar. Stoqet në fund të Janarit ishin 75% të kompletuara sa i përket punës direkte dhe shpenzimet e përgjithshme të prodhimit dhe 100% sa i përket materialeve direkte. Nuk kishte prishje anormale gjatë Janarit. Në kompani gjatë Janarit kishin ndodhur €20,620 kosto të shendimit dhe €22,700 kosto të materialeve direkte.

Kërkohej

- a. Cili është numri i njësive të prishura? (5 pikë)
- b. Cila do të ishte kosto e njësisë ekuivalente për punë direkte dhe shpenzime të përgjithshme të prodhimit? (5 pikë)

(Totali = 20 pikë)

Zgjidha 2:

(a)

a. Norma e përvetësimit të shpenzimeve të përgjithshme është : Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit të përvetësuar / Orët aktuale = $(€330,000 + €110,000) / 220,000 = €2$ për orë të punës. Duke pasur parasysh totalin prej 200,000 orë të punës direkte të buxhetuara për vit, shuma e vlerësuar e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit është $€2 \times 200,000 = €400,000$.

b. Shuma e shpenzimeve të përgjithshme të përvetësuar janë €440,000, dhe një saldo kreditor prej €20,000 nënkupton se shpenzimet e përgjithshme të prodhimit kanë qenë të mbipërvetësuar. Prandaj shpenzimet e përgjithshme aktuale të prodhimit do të jenë për €20,000 më të ulta se sa shpenzimet e përgjithshme të përvetësuar $€440,000 - €20,000 = €420,000$.

(b)

a. Që nga Inspektimi kur ka ndodh në pikën 60% dhe puna në proces e kompletuar 75%, të gjitha njësit në prodhim kanë kaluar përmes inspektimit. Prandaj numri i përgjithshëm i njësive të mira plus njësive të prishura duhet të jetë e barabartë me 11,350. Kjo është

Njësit e mira + 0.135 Njësit e mira = 11,350 njësi ose

Njësit e mira = $11,350 / 1.135 = 10,000$ njësi

Njësit e prishura = $0.135 \times 10,000 = 1,350$ njësit

b. Totali i numrit të njësive ekuivalente si vijon:

	Njësit fizike	Njësit
ekuivalente		
Të kompletuara dhe të transferuara jashtë	8,000	8,000
Të prishura (60% complete)	1,350	810
Puna në proces në fund (75% complete)	2,000	1,500
Totali		
10,310		

Kosto për njësi ekuivalente është $€20,620 / 10,310 = €2$

Problemi 3

Kompania ABC është duke vepruar aktualisht me 80% të kapacitetit të saj maksimal prej 250 orë direkte të punës në ditë. Kompania e prodhon një produkt të vetëm dhe i shet të gjitha prodhimet e saj të rregullta, dhe parashikon se ajo do të jetë në gjendje të mbajë këtë nivel të shitjes edhe në të ardhmen. Kompania është duke kërkuar gjithashtu mënyra për të shfrytëzuar kapacitetet e tepërta dhe po e shqyrton një propozim për të prodhuar 10,000 njësi, si një porosi e veçantë. Porosia duhet të përfundojë për 60 ditë. Çmimi për porosinë e veçantë për njësi është € 7.50. Çmimi i shitjes i rregullt për këtë produkt është 10.50 €. Shpenzimet variabile për njësi janë:

Materialet Direkte	€2.50
Puna direkte (për 1/2 orë)	€3.00
Kosto variabile e përgjithshme	€1.50
Kostot variabile të shitjes	€0.50

Kostot fikse vjetore janë 72,000 €. Kompania nuk do të merr në konsideratë punën jashtë orarit për arsyeje të politikës së menaxherit të prodhimit dhe nëse porosia e veçantë pranohet duhet të shfrytëzohet kapacitetet në dispozicion. Asnjë kosto e shitjeve apo kosto tjera administrative nuk ndërlidhen me porosinë e veçantë. Gjithsesi porosia e veçantë duhet të përfundojë brenda afatit 60 ditor dhe numri i njësisë duhet të jetë 10,000 njësi.

Kërkohe:

- a. Tregoni nëse porosia e veçantë duhet të pranohet. Trego të gjitha llogaritjet (8 pikë)**
- b. Llogaritni me çfarë çmimi për njësi për njësi të porosis së veçantë do të jetë indiferent BB ndërmjet pranimit apo refuzimit të porosis së veçantë. (7 pikë)**
- c. Supozoni që klienti pranon zgjatjen e afatit kohor në këmbim të një ulje në çmimin e shitjes prej € 0.01 për njësi në ditë vonese. (5 pikë)**

(Totali = 20 pikë)

Zgjidhja 3:

Kostot fikse janë jo relevante për këtë kalkulim dhe duhet injoruar

a. Kontributi për porosit e rregullta dhe të veçanta është :

	Shitjet e rregullta	Shitjet e veçanta
Çmimi	10.5	7.5
Materialet Direkte	2.5	2.5
Puna Direkte	3.0	3.0
Variabile të përgjithshme	1.5	1.5
Kosto e shitjeve	0.5	0.0
Kontributi marginal	3.0	0.5

Me pranimin e ofertës special kërkohet kapaciteti prej $10,000 \times 0.5 = 5,000$ orë

Kapaciteti i tanishëm 20% i pa shfrytëzuar $0.2 \times 250 \times 60 = 3,000$ orë në dispozicion për 60 ditë.

Nga kjo 2,000 orë duhet të shfrytëzohen nga porosia e rregullt.

$2,000 \times 1 / 0.5 = 4,000$ njësi nga porosit e rregullta. Nëse i krahasojmë të dhënat, ne shohim :

Kontributi nga porosia e veçantë $(10,000 \times €0.50)$ € 5,000

Humbje: Kontributi nga porosia e rregullt $(4,000 \times €3)$ 12,000

Kontributi neto - me pranimin e porosis së veçantë € (7,000)

Porosia e veçantë nuk duhet të pranohet.

b. $7,000€ / 10,000$ njësi = 0.7€/njësi

$7.5€ + 0.7€ = 8.2€/njësi$

c. Kompania duhet të pranoj ofertën pasi që pa penguar prodhimet e rregullta do të ketë një reduktim mesatar të çmimit 0.205€ ($0.01 + 0.4 / 2 = 0.205€$); ($100€ * 0.1 = 1€$, për ditën e parë dhe $100€ * (0.1 * 40) = 40€$, për ditën e katërdhjetë)

Kontributi nga porosia e veçantë (para zbritjes) $(10,000 \times €0.50)$ € 5,000

Kontributi nga porosia e veçantë (pas zbritjes) $(6,000 \times €0.50)$ € 3,000

Kontributi nga porosia e veçantë (pas zbritjes) $(4,000 \times (€0.50 - 0.205))$ € 1,180

Total Kontributi neto nga porosia e veçantë (pas zbritjes) 4,180

Problemi 4

Procesi i prodhimit në kompaninë ABC përbëhet nga disa procese të ndryshme. Në procesin G, produktet e përbashkëta (A1 dhe A2) prodhohen me një koeficient 5:3 nga aspekti sasior (vëllimit) i lëndëve të para të futura në proces. Humbja normale gjatë këtij procesi pritet të jetë 5% e lëndëve të para të futura në proces. Humbjet kanë një vlerë të realizueshme (të shitjes) prej 5€ për litër. Kompania nuk mban punë në progres. Kostot e përbashkëta shpërndahen në produktet e përbashkëta sipas metodës së *matjes fizike* apo *vëllimit fizik*.

Informatat në vijim kanë të bëjnë me procesin G për muajin e kaluar:

Lëndët e para të futura në proces	60,000 litra (me një kosto prej €381,000)
Fitimi anormal	1,000 litra

Kostot tjera:

Puna direkte	€180,000
Shpenzimet direkte	€54,000
Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit	110% e kostos së punës direkte

Kërkohe:

(a) Përgatisni llogarinë (konton) T të procesit G për muajin e kaluar në të cilin duhet paraqitni për secilin produkt të përbashkët daljet (outputi apo prodhimi) si nga aspekti sasior ashtu edhe nga ai financiar.

(10 pikë)

Në fund të procesit G, kompania mund ta shes produktin A1 me çmim prej €20 për litër. Kompania është duke marrë në konsideratë propozimin për ta vazhduar prodhimin e produktit A1 në procesin H në mënyrë që të *prodhoj produktin PP1*. Procesi H ka kapacitet të lirë për ta realizuar këtë punë. Kostot shtesë në procesin H do të jenë 4€ për litër të futur në këtë proces nga procesi paraprak G. Në procesin H humbja normale sasiore do të jetë 10% e hyrjes (inputit) në këtë proces. Kjo humbje nuk ka vlerë të realizueshme (të shitjes). Produkti i prodhuar PP1 do të mund të shitej me një çmim prej 26€ për litër.

(b) Bazuar në aspektin financiar, përcaktoni nëse produkti A1 do të duhej të vazhdoj prodhimin në procesin H.

(7 pikë)

(c) Nga aspekti i procesi G, shpjegoni dallimin ndërmjet termeve “shpenzimet direkte” dhe “shpenzimet e përgjithshme të prodhimit”.

(3 pikë)

(Totali = 20 pikë)

(a)

Procesi G

	Litra	€		Litra	€
MD	60,000	381,000	Outputi (3):		
PD		180,000	A1 (4)	36,250	507,500
Shpenzimet direkte		54,000	A2 (4)	21,750	304,500
SHPP (1)		198,000	Normal loss (2)	<u>3,000</u>	<u>15,000</u>
Fitimi anormal (4)	<u>1,000</u>	<u>14,000</u>			
	61,000	827,000		61,000	827,000

Përlllogaritjet (1-4):

1 Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit = $110\% \times 180,000 = €198,000$

2 Humbja normale = $5\% \times 60,000 = 3,000$ litra me $5 = €15,000$

3 Dalja (outputi) total = $61,000 - 3,000 = 58,000$

Ndarja A1 : A2 sipas raportit 5 : 3

A1 = $(5 \div 8) \times 58,000 = 36,250$ litra

A2 = $(3 \div 8) \times 58,000 = 21,750$ litra

4 Kosto për litër:

Kosto totale neto = $381,000 + 180,000 + 54,000 + 198,000 - 15,000$
= €798,000

Dalja (outputi) i pritur = $60,000 \times 95\% = 57,000$ litra

Kosto për litër = $798,000 \div 57,000 = €14$

Vlerësimet:

Fitimi anormal = $1,000 \times 14 = €14,000$

Produktet e përbashkëta:

A1 $36,250 \times 14 = €507,500$

A2 $21,750 \times 14 = €304,500$

(b)

100 litra të produktit A1	€
Të hyrat nëse shiten në pikën e ndarjes, pa procesim të mëtutjeshëm	2,000
Të hyrat (nga PP1) nëse shiten pas procesimit të mëtutjeshëm $(100 \times 90\%) \times 26$	2,340
Të hyrat shtesë 1	340
Kostot shtese (procesi H) 1,	400

Kostot shtesë i tejkalojnë përfitimet shtesë për €60 për çdo 100 litra të procesimit të mëtutjeshëm të produktit A1. Për shembull, nëse prodhimi (dalja) prej 36,250 litra të produktit A1 është procesuar më tutje për të prodhuar produktin e ri PP1, kostot shtesë do të tejkalojnë të hyrat shtesë me për €21,750 $(36,250 : 100 \times 60)$. Prandaj produkti P1 nuk duhet të procesohet dhe të shëndrohet në produktin PP1.

(c) Shpenzimet direkte janë kostot, të ndryshme nga materialet dhe puna, të cilat në mënyrë direkte mund të gjurmohen në procesin (G). Një shembull i kostove të tilla është marrja e pajisjeve speciale me qira, të cilat kërkohet vetëm për atë proces. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit janë shpenzimet të përgjithshme të fabrikës të cilat duhet të përpjesëtohen në procese të ndryshme. Shembull të tyre janë qiraja, rryma e fabrikës, etj.

Problemi 5

Kompania ABC prodhon një linjë për këpucë vrapimi. Në fillim të periudhës paraqitën planet që vijojnë, për prodhimin dhe kostot:

Njësitë për prodhim dhe shitje	25,000
Kosto standarde për njësi:	
Materialet e drejtëpërdrejta	€10
Puna e drejtëpërdrejtë	8
Shpenzimet indirekte variabile	4
Shpenzimet indirekte fikse	3
Kostoja totale për njësi	<u>€25</u>

Gjatë vitit u prodhuan dhe u shitën 30,000 njësi. Për këtë patëm këto kosto aktuale:

Materiale të drejtëpërdrejta	€320,000
Punë e drejtëpërdrejtë	220,000
Shpenzime indirekte variabile	125,000
Shpenzimet indirekte fikse	89,000

Nuk kemi stoqe fillestare dhe përfundimtare për materialet e drejtëpërdrejta. Mospërputhja e çmimit të materialeve të drejtëpërdrejta prej 5,000 € ishte e pafavorshme. Në prodhimin e 30,000 njësive, u punua për një total prej 39,000 orësh, 4% më shumë orë se sa standardi i lejuar për prodhimin aktual. Kostot indirekte iu aplikuan prodhimit, duke përdorur orët e punës së drejtëpërdrejtë.

Kërkohet:

a. Përgatitni një raport të performancës, duke krahasuar kostot e pritshme me kosto aktuale.

b. Përcaktoni sa vijon:

- i. *Mospërputhjen e përdorimit të materialeve të drejtëpërdrejta.*
- ii. *Mospërputhjen e normës së punës së drejtëpërdrejtë.*
- iii. *Mospërputhjen e përdorimit të punës së drejtëpërdrejtë.*
- iv. *Mospërputhjet e vëllimit dhe të shpenzimit të shpenzimeve indirekte fikse.*
- v. *Mospërputhjet e shpenzimit dhe e efikasitetit të shpenzimeve indirekte variabile.*

c. Përdorni T-Llogaritë për të treguar rrjedhën e koston përgjatë sistemit. Në paraqitjen e rrjedhjes, nuk keni nevojë të tregoni mospërputhjet e detajuara të kostove indirekte. Tregoni vetëm mospërputhjet e mbi-dhe-nënaplikuara për shpenzimet indirekte fikse dhe variabile.

(Totali = 2x7pikë + 6 pikë = 20 pikë)

Zgjidhja 5:

a.

Correr Co.
Raporti i Performancës

	<u>Kostot Aktuale</u>	<u>Kostot e Buxhetuara^a</u>	<u>Varianca</u>
<i>Materialet direkte</i>	€ 320,000	€ 300,000	€ 20,000 PF
<i>Puna Direkte</i>	220,000	240,000	(20,000) F
<i>Sh.P. Variabile</i>	125,000	120,000	5,000 PF
<i>Sh.P. Fikse^b</i>	<u>89,000</u>	<u>75,000</u>	<u>14,000</u> PF
	<u>€ 754,000</u>	<u>€ 735,000</u>	<u>€ 19,000</u> PF

^a Duke e përdorur kostot standard variabile për njësi për materialet direkte, punën direkte, dhe sh.p.p. variabile (psh., €10 × 30,000 për materialet direkte; sh.p.p. fikse = €3.00 × 25,000).

^b Vetëm variancën e shpenzimeve.

b. i. $Variance\ Totale = V\check{C}M + VPM$
 $€20,000\ PF = €5,000\ PF + VPM$
 $VPM = €15,000\ PF$

ii. $VNP = (NA - NS)OA$

$$OS = 39,000/1.04$$

$$= 37,500\ orë$$

$$NS = €240,000/37,500$$

$$= €6.40$$

$$NS \times OA = €220,000$$

$$VEP = €220,000 - (€6.40 \times 39,000)$$

$$= €29,600\ F$$

iii. $VEP = (OA - OS)NS$
 $= (39,000 - 37,500)€6.40$
 $= €9,600\ PF$

$$\begin{aligned}
 \text{iv. Varianca e shpenzimeve (Sh.F.)} &= \text{Aktuale F} - \text{Buxhetuara F} \\
 &= €89,000 - €75,000 \\
 &= €14,000 \text{ F}
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 \text{Varianca e Vëllimit} &= \text{Buxhetuara F} - \text{Shkalla SO} \times \text{OS} \\
 &= €75,000 - (€2.40^* \times 37,500) \\
 &= €15,000 \text{ F}
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 \text{*Orët e lejuara për njësi} &= 37,500/30,000 \\
 &= 1.25 \text{ ora për punën direkte për njësi}
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 \text{ÇOS Fikse} &= €3.00 \text{ njësi}/1.25 \text{ ora për punën direkte për njësi} \\
 &= €2.40 \text{ për orë}
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 \text{ÇOS Variablie} &= €120,000/37,500 \\
 &= €3.20
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 \text{v. Varianca e shpenzimeve variabile prodhimit} &= \text{Sh.p.VA} - \text{NVSSh.VSVOR} \times \text{OA} \\
 &= €125,000 - (€3.20 \times 39,000) \\
 &= €200 \text{ PF}
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 \text{VSh.V} &= (\text{OA} - \text{OS})\text{ÇOS Variabil} \\
 &= (39,000 - 37,500)€3.20 \\
 &= €4,800 \text{ PF}
 \end{aligned}$$

c.

<i>Lënda e Parë</i>				<i>Puna në Proces</i>			
(a)	315,000	315,000	(b)	(b)	300,000	750,000	(f)
				(c)	240,000		
				(d)	120,000		
				(e)	90,000		

<i>Mallrat e gatëshme</i>			
(f)	750,000	750,000	(g)

<i>VNM</i>			
(a)	5,000	5,000	(h)

<i>VPM</i>			
(b)	15,000	15,000	(i)

<i>Llogarit e Pagueshme</i>			
		320,000	(a)

<i>Rrogat e Pagueshme</i>			
		220,000	(c)

<i>VNP</i>			
<i>(j)</i>	<i>29,600</i>	<i>29,600</i>	<i>(c)</i>

<i>LEV</i>			
<i>(c)</i>	<i>9,600</i>	<i>9,600</i>	<i>(k)</i>

<i>Ll.Kontrolluse e Sh.p. Variabile</i>			
<i>125,000</i>		<i>120,000(d)</i>	
		<i>5,000</i>	<i>(l)</i>

<i>Ll.Kontrolluse e Sh.p. Variabile</i>			
	<i>89,000</i>	<i>90,000</i>	<i>(e)</i>
<i>(m)</i>	<i>1,000</i>		

<i>KMSH</i>			
<i>(g)</i>	<i>750,000</i>	<i>29,600</i>	<i>(j)</i>
<i>(h)</i>	<i>5,000</i>	<i>1,000</i>	<i>(m)</i>
<i>(i)</i>	<i>15,000</i>		
<i>(k)</i>	<i>9,600</i>		
<i>(l)</i>	<i>5,000</i>		